



**Për të gjithë dhe
jo për disa!**

Të gjithë duhet të kemi mundësi të barabarta për të pasur sukses dhe për të marrë ndihmë kur ne kemi nevojë për të. Kjo nuk është siç duket sot. Shumë gjëra të mira shkojnë për ata që tashmë kanë më shumë. Ne kemi nevojë për një shoqëri të ndershme dhe miqësore në mjedis, si në nivel lokal, ashtu në atë kombëtar dhe global. Ne duam të mbrojmë më të mirën e shoqërisë norvegjeze - ndryshime jo të mëdha, papunësi të ulët dhe shoqëri të fortë. Ne duhet të reduktojmë pabarazitë, të forcojmë mirëqenien dhe të luftojmë varfërinë.

Kriza klimatike dhe shkatërrimi i natyrës kërcënojnë të gjithë të ardhmen tonë, pasi fitimet afatshkurtra janë vendosur përpara mjedisit. Përgjigja ndaj krizave, me të cilat ne po përballlemi tani, duhet të jetë një plan gjithëpërfshirës dhe i drejtë për klimën dhe industrinë. Një plan që, me investime të konsiderueshme do të sigurojë detyrat për industrinë në vitet e ardhshme. Ne do ta ndryshojmë Norvegjinë për t'u bërë një vend pionier, e cila tërheq botën në një drejtim miqësor ndaj mjedisit dhe klimës.

Është koha për një politikë të re ekonomike. Ajo, e cila mund të zgjidhë krizën klimatike dhe në të njëjtën kohë të zvogëlojë pabarazinë dhe të zgjidhë problemin e papunësisë. Plani SV për një ndryshim të drejtë dhe të gjelbër ka të bëjë me shpresën dhe ndryshimin. Ne do të zvogëlojmë pabarazitë, do të ndërtojmë industrinë dhe do të ndajmë përfitimet dhe detyrimet. Por, ne duhet të refuzojmë politikat gri, të paqëndrueshme dhe të ashpra që qeveria po ndjek. Ne do të bëjmë vendin të gjelbër për të gjithë dhe jo gri për disa.

Sosialistisk Venstreparti

Hagegata 22, 0653 Oslo

21 93 33 00

post@sv.no

sv.no

